



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:262111
Datë: 22.02.2023
Numri i dokumentit: 04001101

ARJ.nr.8/2023

Gjykata Supreme në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Beshir Islami dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, R. S., Avokat nga Prishtina kundër të paditurit, Oda e Avokatëve të Kosovës,(OAK), me seli në ., me bazë juridike, anulim i vendimit të organit të paditur, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar nga paditësi, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.142/2022, të datës 04.10.2022, në seancën e mbajtur me datë, 21 Shkurt 2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi, R.S., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.142/2022 të datës 04.10.2022.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.142/2022, të datës 04.10.2022, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2049/18, i datës 10.12.2021.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësi në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes së rregullave të procedurës administrative dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të anulohet aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA nr. 142/2022 të dt. 04.10.2022 si të pa bazë dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë përsëri në rishqyrtim.

Gjykata Supreme në bazë të nenit 53, të Ligjit për Konfliktet Administrative ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe atij të shkallës së parë, kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe shkresave tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin përfundimtarë në procedurë administrativ të paditurit Oda e Avokatëve të Kosovës, VKA nr. 17-11/17 të dt. 28.06.2018, refuzohet ankesa e paraqitur nga paditësi ndërsa vërtetohet vendimi i Komisionit Disiplinor të OAK V.KD nr. 17-8/2017 i dt. 11.010.2017, me të cilin ishte shpallur përgjegjës dhe ishte gjobitur me gjobë në shumë prej 300.00€uro për shkak të shkeljes disiplinore nga neni 106 par. 3 të Statutit të OAK lidhur me nenin 40. Dhe 41 të KEPA.

Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Administrativ në Prishtinë duke vendosur sipas padisë së paditësit, me datë 10.12.2021, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor dhe pasi bënë vlerësimin e provave deklarimeve të palëve merr aktgjykimin A.nr.2049/18, me të cilin refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurit, V.KA.nr. 17-11/17, të dt. 28.06.2018. Në arsyetim ndër të tjera arsyeton se gjykate nuk gjeti prova se nga i padituri janë shkelur rregullat e procedurës në lidhje me dëgjimin e individëve të propozuar nga paditësi, dhe vie në përfundim se e padituri ka respektuar barazinë e palëve në procedurë duke bërë dëgjimin dhe iniciimin e procedurës disiplinore nga ana e prokurorit disiplinor të OAK, dhe deklaratën provat dhe dëshmitë e paraqitura nga paditësi. Tutje vlerëson se vendimi i organit të paditur është në harmoni me nenin 47 të LPPA, i njëjti është i qartë dhe përmbajtësor si akt administrativ. Pretendimet e paditësit se vendimi i kontestuar i OAK nuk është i drejtë dhe ligjor i refuzon si jo të bazuara lidhur me mos vërtetimin e gjendjes faktike, i cili e ndërlidh çështjen me natyrën e lëndës civile të cilën e ka përfaqësuar në gjykatë. Andaj vlerëson se procedura disiplinore ndaj paditësit nuk është e lidhur me lëndën të cilën e ka përfaqësuar në gjykatë por me veprimet e paditësit. Po ashtu gjen se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë nga organi i paditur.

Gjykata e Apelit në procedurë ankimore me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur si në kuptim të nenit 49 të LKA-së dhe 194, të LPK-së, (ligj i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të LKA-së), e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e vërteton së të drejtë dhe ligjor. Në arsyetim pasi bënë përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, u referohet dispozitave ligjore procedurale dhe materiale të njëjta, dhe bazuar në shkaqet dhe arsyet e njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, me refuzimin e kërkesë padisë së paditësit, dhe vërtetimin e vendimit të OAK. Po ashtu vlerëson se nga i padituri në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar që paditësi ka kryer shkelje disiplinore, ashtu që nga procesverbali i dt. 11.10.2017, sipas deklaratës së Sh. T. të dhënë pran zyrës së Prokurorit Disiplinor të OAK, vërtetohet se paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor në Gjykatën Themelore në Prishtinë i ka thënë gjyqtarës, “Kush ta ka dhënë ty Diplomën ti nuk je për këtë vend ti nuk din me gjyku”. Andaj duke u bazuar në këtë komisioni disiplinor me të drejtë merr vendim dhe

vendos që paditësit të shpallet përgjegjës dhe gjobitet për shkak të shkeljes së nenit 106, par. 3 të Statut të OAK, lidhur me nenin 40 dhe 41 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Pretendimet e paditësit i refuzon si jo të bazuara në mungesë të provave se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkeljet sipas pretendimeve në ankesë.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjen se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vendosur me refuzimin si të pa bazuar të ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, nga se aktgjykimi i kontestuar nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës administrative, procedurës së konfliktit administrativ, apo me aplikim të gabuar të drejtës materiale siç pretendon paditësi në kërkesë. Aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm në dispozitiv, dhe në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar, bazuar në prova dhe ligj të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Paditësi në kërkesë për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor mes tjerash pretendon se, se nga gjykatat më të ulëta është dashur të dëgjohen të dyja palët në mënyrë të barabartë duke respektuar parimin, “audiatur et altera pars”, tutje e përshkruan rastin të cilin ishte duke e përfaqësuar në gjykatën e shkallës së parë në lëndën C nr.41/2014, sipas rrjedhës së saj, se diapozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është në kundërshtim me arsyetimin e tij dhe nuk janë përshirë faktet vendimtare, se vendimi i OAK nuk mundet të jetë titull përmbarues etj., kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të bazuara në prova dhe dëshmi të argumentuara për tu vendosur ndryshe në këtë çështje sepse nuk ofrohen dëshmi që në bazë të deklarimeve shtesë si propozon ai do të vendosej ndryshe kjo çështje. Po ashtu ndërlihdja e kësaj çështje me lëndën, C nr. 41/2014, nuk është me ndikim dhe nuk argumenton asnjë fakt tjetër që do të përjashtonte veprimet e paditësit sipas çështjes në shqyrtim lidhur me shkeljet e Kodit të Etikës për Avokat dhe Statutit të OAK. Gjer sa nga provat e administruar në organin e paditur dhe gjykatat e instancave më të ulëta si në aktgjykimet e tyre, duke bërë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit përfundimtar të organit të paditur të OAK, pa dyshim vërtetohet në mënyrë të mjaftueshme, në bazë të fletëparaqitjes së gjyqtarës S. Bogaj deklaratave të dhëna me shkrim, dhe inicimit të procedurës disiplinore nga ana e prokurorit disiplinor që paditësi ka kryer veprën inkriminuese, si më lartë, me çka kryer shkelje disiplinore nga nenin 106.3, të Statutit të OAK, lidhur me nenin 40 dhe 41 të KEPA dhe për këtë me të drejtë është shpallur përgjegjës nga komisioni disiplinor i OAK dhe është dënuar me gjobë si në vendimin e organit të paditur të shkallës së parë V.KD.nr.17-8/2017 të dt. 11.10.2017 i vërtetuar me vendimin përfundimtar të shkallës së dytë V.KA.nr. 17-11/17 të dt. 28.06.2018, të konfirmuar edhe në procedurë gjyqësore nga instancat më të ulëta si vendime të drejtë dhe ligjor.

Nga theksimet si më lartë rezulton se aktgjykimi i shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë janë qartë kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme lidhur me gjendjen faktike dhe ligjore për të gjitha faktet vendimtare, andaj nga kjo rezulton se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 paragrafi 1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
ARJ.nr.8/2023, me datë 21 Shkurt 2023

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani